- Sportive - Kulinare	- Marketing (Panaire, Reklama, Promovim i Produkteve Lokale, Atraksionet Turistike etj.) - Përmirësimi i Shërbimit ndaj Klientit përmes rritjes së cilësisë nëpërmjet akreditimit dhe Certifikimit - Zgjerim dhe linja të reja shërbimi: Patja e aksesit në ofertën dhe zinxhirin turistik kombëtar dhe ndërkombëtar	- Tradicionalë dhe panarriet - Mbështetja për zinxhirët dhe produktet turistike lokale - Mbështetje ndaj organizatave të reja turistike - Skema dhe aktivitete Trajnimi dhe Ngritje Kapacitetesh - Heqje të taksave vendore ose përfitime tatimore - Investim në rrjetet lokale të rrugëve etj. - Investime në infrastrukturën arsimore në shërbim të prodhuesve lokal - Lobim për subvencione kombëtare për produktet lokale dhe mbështetje për promovimin e cilësive të tyre në rang ndërkombëtar - Lobim tek donatorët ndërkombëtar të specializuar dhe të gatshëm të investojnë në këtë fushë: USAID, GIZ, III, IV, V IPA .
--	--	---

Tabela 7: Tabela e Strategjive Konkurruese dhe aksioneve respektive publike në mbështetje të tyre në Sektorin e Turizmit

2.3.3 Analiza e sektorëve kryesorë ekonomike: Industria minerare

Analiza e këtij sektori nuk kryhet në këtë material, sëpari sepse nuk është vetëm përgjegjësi e autoriteteve publike të FA por e autoriteteve kombëtare qendore. Fakti që ndonjë NJQV në ZF, ka të drejtën e rentës për aktivitete minerare nuk e ndryshon këtë supozim për atë kohë sa autoritetet nuk kanë të drejtë të vendosin nivelin e kësaj rente dhe gjithashtu të taksave të tjera, tarifave dhe licensat e aplikuara ndaj këtij aktiviteti. Në të njëjtën mënyrë ZF nuk ka të drejtë për vendosjen e standardeve për aktivitetet në këtë zonë dhe skemat e kompesimit për dëmet, apo ndryshimet në ekosistemet dhe territorin e kësaj zone. Duhet theksuar se megjithatë, rëndësia e përfshirjes së aktorëve lokal në të gjithë procesin e ngritjes së kuadrit të këtij aktiviteti (ligjor dhe fiskal), duke qenë se në fund të ditës mbartësit përfundimtar të pasojave të këtij aktiviteti janë banorët e këtyre zonave.

2.3.4 Analiza e sektorëve kryesor ekonomik: Industria Hidroenergjetike


Sic është theksuar në seksionet e mëparëshme kjo ZF është pjesë e një prej 6 baseneve ujore më të rëndësishëm në vend.

HEC-et e Shkopetit janë në kufi të kësaj zone. Të tjera janë planifikuar dhe u janë dhënë të drejta koncensionare, si ajo e zonës së Klosit. Sërish, autoritetet qendrore janë përgjegjëse për drejtimin e politikave dhe veprimin në këtë zonë; megjithatë koordinimi dhe përfshirja e zyrtarëve të zgjedhur të ZF dhe komuniteteve lokale është e rëndësishme që prej fillimit si dhe negociimi me ta mund të jetë problematik; kjo të paktën është provuar në rastin e Klosit.

2.4 Pikat kryesore, konkluzione për hartimin e politikave

Pikat kryesore për hartimin e politikave janë përmbledhur në analizën e mëposhtme SWOT, e cila përmbledh shumë prej pikave të shpjeguara në Kapitullin 2.

Ne theksojmë faktin e konsiderimit të tij vecanërisht në përputhje me rekomandimet për drejtimin e politikave me strategjitë konkurruese dhe aksionet e aktorëve privat të paraqitur në fund të çdo seksioni.






Figure 23: Summarized Value Chain Analysis in Sector of Agriculture supporting suggestions for Policy directions




Figure 24: Summarized Value Chain Analysis in Sector of Tourism supporting suggestions for Policy directions and decision making of public local officials

3.Hartëzimi I shërbimeve lokale ne Zonën Funktionale

3.1 Furnizimi me Ujë dhe Kanalizime




Figure 25: Aksesit në ujë dhe pishëm në ZF dhe rrjeti i ujit

Burimi: Intervista me zyrtarë publik dhe specialist viti 2014

aksesin në sistemin e rrjetit të ujit të pishëm. Vetëm bashkia Burreli dhe komuna Derjan kanë akses të plotë në rrjetin e furnizimit me ujë. Si një e tërë ZF ka një akses në shërbimet e furnizimit me ujë në nivelin e 73%, që është nën mesataren kombëtare prej 81%.

Përsa i përket aksesit në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza, duket se vetëm bashkia Burrel siguron një akses të tillë, për të paktën 60% të banorëve të saj. Njësit e tjera të Qeverisjes Vendore që përbëjnë ZF edhe pse kanë investuar për akses në sistemin e furnizimit me ujë të pishëm kanë mbetur prapa në kanalizimet e ujërave të zeza. Aksesit i banorëve në të gjithë ZF në sistemin e ujërave të zeza është në nivelin e **24%, shumë më poshtë mesatares kombëtare prej 51%.**

Një nga arsyet është nevoja për investime madhore për ndërtimin e sistemit të kanalizimeve, këto investime janë zvendësuar me (gropa septike).

ZF ka burime të pasura ujore natyrore si prrenjë, liqene dhe lumenj. Nga kjo perspektive, prezenca e burimeve ujore në këtë zonë nuk ka qenë një sfidë për banorët. Në fakt të gjitha familjet kanë akses në ujë të pijshëm. Harta në të majtë përshkruan këtë situatë mjaft

qartë. E njëjta gjë nuk mund të thuhet për




Figure 26: Aksesit në ujë dhe pishëm në ZF dhe rrjeti i ujit

Burimi: Intervista me zyrtarë publik dhe specialist viti 2014




Figure 27: Aksesit në sistemin e kanalizimeve dhe %e familjeve në ZF me WC me shkarkim

Burimi: Intervista me zyrtare public dhe specialist viti 2014 CENSUS 2011

vendimtarë. Nga informacionet e mbledhura në terren vetëm bashkia Burrel ka një entitet të bazuar në aksionerë sic është " SH.A Ujësjellës Kanalizime Burreli" ky entitet është përgjegjës për menaxhimin e sistemeve të ujit dhe ujërave të zeza. NjQV si Derjan, Macukull, Koms, Ulëz, Gurrë, Lis, Koms, Klos etj kanë vetë përgjegjësinë për menaxhimin dhe financimin e mirëmbajtjes së sistemit të ujit dhe kanalizimeve.

Sic vihet re për të gjitha NjQV përveç Burrelit, Lis dhe Koms bilanci përfundimtar i të ardhurave dhe shpenzimeve është negativ. Në fakt të gjitha këto NJQV janë të vetmit që kanë shkallën e arkëtimit të tarifave të ujit më shumë se 50%.

Burreli dhe Lis aplikojë tarifën për m³ ndërsa komuna Koms aplikon tarifën për m³ dhe tarifë fikse .Gjëja më e rëndësishme që vihet re është, fakti se të tre këto NJQV së bashku me Ulëzën (qendra e Komunës) kanë mates (sahat) uji të instaluar, por ende jo tërësisht për të gjithë banorët. Struktura e tarifave dhe masa e mbulimit për

orë janë paraqitur në grafikun në të djathtë. Vihet re se tarifa fikse e aplikuar për Klosin, Gurrën, Ulëzën, Macukullin janë përkthyer




Figure 28: Tarifa në Lek/m³ dhe mbulimi në % për 24 orë

Source: I Aksesit në ujin e pijshëm në ZF dhe rrjeti I ujit

Burimi: Intervista me zyrtare public dhe specialist viti 2014 dhe studim

në ekuivalent i tarifave / m³ **duke supozuar se çdo familje konsumon mesatarisht 1 m³ në ditë**. Mesatarisht ZF Mat, ka 14 orë mbulimi me shërbim në ujë të pishëm në 24 orë, për pjesë e popullsisë e cila ka akses në rrjetin e ujësjellësit.

Pjesa më e madhe e investimeve në sistemet e ujësjellësit janë të reja dhe të realizuara kryesisht nga FSHZH si ujësjellësat në komunat Ulëz, Gurrë, Baz, Koms në një total rreth **199 ml lekë**. Investimet e tjera janë kryer me grantet konkurruese (FZHR) janë në proces realizimi ujësjellësi i Klosit, Derjan etj

Përsa i përket sistemit të kanalizimeve të ujërave të zeza në bashkinë e **Burrelit mbulohen 60% e banorëve, në komunën Ulëz 100 familje, bashkia Klos 90 familje**, pjesa tjetër e banorëve të ZF kanë vetëm gropa septike. Investimi në sistemin e kanalizimeve të ujërave të zeza nga FSHZH, FZHR dhe burime të tjera të financimi kanë qenë pothuajse zero në 5 vitet e fundit.




Figure 29: Veprime të zyrtareve public per te permiresuar sistemin e ujit ne kontekstin e ZF

Source: Analiza e ekipit dhe të dhëna nga DPUK dhe situatë në ZF

shitjes.

Në Shqipëri komponentet me peshë më të lartë specifike në kostot e drejtpërdrejta janë kostot e energjisë Elektrike me (40%) dhe kostot e Punës me (42%). Në krahasim me pjesën tjetër të vendit Mat është në pozitë të mirë në krahasim me tarifën, për shkak të investimeve relativisht të reja në këtë sektor ka një nivel më të lartë të, duhet që kjo situatë të mbahet me veprimet e duhur nga autoritetet e ZF . Figura këtu sipër në të djathtë jep kontekstin dhe faktorët që ndikojnë në nivelin aktual të tarifave të aplikuara në ZF. Në të majtë është ajo çfarë është rekomanduar për zyrtarët publikë Administratën Lokale në aspektin e veprimeve që ata duhet të përmbahen (në pjesën e sipërme) dhe atë për çfarë ata janë të inkurajuar për të bërë (në pjesën e poshtme të skemës).

Si rregull i përgjithshëm dhe i bazuar në udhëzimet e benchmark të Ministrisë së Transportit dhe Punë Publike komponenti i tarifës mesatare / m³ është diferenca midis kostos së drejtpërdrejtë të prodhimit dhe kostos së

3.2 Rrugët dhe transporti publik

ZF e Burrelit dhe e Klosit ndodhet në pjesën qendrore të Shqipërisë së sipërme, në një distancë pak a shumë të barabartë nga kryeqyteti i vendit (Tirana), pika kufitare veri lindore (Bllatë) e Shqipërisë me Maqedoninë dhe pikë akses në pjesën perëndimore detare (Porti i Shëngjinit). Zona funksionale lidhet me të gjitha këto pika nëpërmjet rrugëve që **janë pjesë e rrjetit kombëtar rrugor**. Gjatësia dhe rrugëtimi i segmenteve kombëtare përgjatë dhe jashtë ZF tregohet në figurën në të djathtë. Popullsia dhe produktet e ZF mund të arrijnë tregjet rajonale, në pjesën lindore dhe perëndimore të Shqipërisë për më



Figura 1: Rrjeti kryesor rrugor kombëtar n ZF dhe gjatësitë respective në Km.

pak se 2 orë me automjete. Segmentet e rrugëve kombëtare edhe pse nuk janë autostrada të klasit të parë, përgjithësisht janë në gjendje të mirë dhe të mirëmbajtura. Pjesë e këtij rrjeti kombëtar rrugor është edhe segmenti Burrel-Klos që lidh qendrat kryesore të ZF. Është pjesë e rrugës kombëtare që të çon në Dibër dhe në pikën kufitare lindore të Bllatës. Në të ardhmen ZF-ja do të ketë akses (nëpërmjet




Figure 30: Gjatësia e Rrugëve Lokale që lidhin NJQV-të e ZF me Burrelin

Klosit) në autostradën kryesore veri-lindore **“Rruga e Arbrit”** që do të lidh Tiranën me Dibërën në Maqedoni, që është **programuar për t’u tenderuar nga Qeveria Shqiptare**.


Ky investim, që për momentin një investim është programuar të implementohet nëpërmjet financimit të huaj, do të shkurtojë kohën dhe të lehtësojë aksesin e popullsisë të ZF në tregjet lindore, rajonale dhe të huaj.

Rrjetet rrugore sekondare konsistojnë në rrjetet rajonale dhe rurale. Të gjitha NJQV-të janë të lidhura me Burrelin nëpërmjet rrugëve lokale, gjatësia e të cilave jepet në grafën e Figurës 36.


Macukull është pika më e largët, ndërsa Koms është NJQV-ja më e afërt.

Rrjeti i rrugëve dytësore përbëhet nga afërsisht 255 km rrugë lokale. 135 Km konsiderohen punë rajonale dhe mirëmbahen nga “Ndërmarrja Rajonale e Mirëmbajtjes së Rrugëve” (NRMR) në Mat. Pjesa tjetër, 120 km rrugë janë rrugë rurale lokale dhe mirëmbahen nga secila NJQV, nëpërmjet nën-kontraktorëve privatë, përmes procedurave të hapura të tenderimit, që lancohen çdo vit përmes sistemit të qendëruar të prokurimit publik.

Më shumë se 75% e këtyre rrugëve rurale janë me zhavorr dhe pjesa tjetër është ose asfalt ose e pashtuar. Sipas intervistave me zyrtarët përgjegjës në NJQV, punonjësit dhe personeli teknik i NRMR Mat, rreth 70% e këtyre rrugëve lokale janë në gjendje të keqe, veçanërisht rrugët me zhavorr dhe të pashtuara, të cilat kërkojnë të paktën mirëmbajtje



Figurea 31: Struktura dhe Gjendja e Rrugëve Rurale



Figurea 32: Hartë e Strukturës së Rrugëve në ZF.

minimale (e cila konsiston kryesisht në blerjen vjetore të zhavorrit dhe vendosjen përgjatë rrugës për riparime thelbësore të vazhdave dhe gropave. Nuk është parashikuar rivlerësim apo ri-shtrim me zhavorr. Operacioni normal i ri-shtrimit me zhavorr është zëvendësuar efektivisht nga zëvendësimi i qëndrueshëm i zhavorrit me rregullime të vogla të rrugës së shtruar. Grafi i figurës 37 përmbledh informacionin, i cili prezantohet në mënyrë më të detajuar në Aneksin Nr. ... të këtij dokumenti, ndërsa harta e Figurës 38 tregon të njëjtin informacion për secilën zonë dhe NJQV. Rrjeti ekzistues i rrugëve është i mjaftueshëm për garantimin e aksesit

në arsim, shëndetësi dhe shërbime administrative në të gjithë ZF, megjithëse cilësia e tyre ka nevojë të vazhdueshme për përmirësim nëpërmjet mirëmbajtjes dhe investimeve të reja.

Financimi i operacioneve të mirëmbajtjes për rrugët rurale lokale realizohet nëpërmjet buxhetit individual të çdo NJQV-je. Investimet e reja dhe mirëmbajtja e

rrugëve rajonale bëhet ose fondet rajonale të dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit (FSHZH). Në lidhje me të fundit pa përjashtim fondet arrijnë mesatarisht 5% të buxhetit total të




Figura 33: Mirëmbajtja e Rrugëve Lokale dhe Investimet e Reja në milionë Lek në Rrugët Lokale dhe Rajonale sipas burimeve të ndryshme

Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në informacionin e marrë nga zyrtarët e ZF.

çdo NJQV-je, e cila vuan vetëm për nivel minimal mirëmbajtjeje, duke ia lënë kështu FSHZH-së barrën e investimeve të reja. E njëjta gjë është e vërtetë për NRMR dhe rrugët rajonal . Pjesë e shpjegimit lidhet gjithashtu me faktin që prej 2008, Qeveria Shqiptare kërkoi të centralizoj investimet kryesore publike për rrugët rajonale dhe lokale së pari nëpërmjet Fondit të Zhvillimit të Rajoneve (FZHR) dhe pastaj së bashku me FSHZH, për të rritur efencën e investimeve nëpërmjet konceptit të ekonomive të shkallës. Në rastin e ZF duket se kjo strategji ka funksionuar vetëm për disa prej NJQV-ve si p.sh. (Lis, Gurre, Komsi, Klos)dhe më pak për të tjerat. Incidenca e investimeve publike kombëtare është më e pabarabartë.

Edhe pse ZF e Matit ka përfituar më shumë nga investimet për frymë krahasuar me Dibrën, si në investimet rajonale dhe kombëtare, incidenca e investimeve midis NJQV-ve, sic mund të jetë parë më sipër në Figurë, është e pabarabartë, me Klosin, Komsin, Lisin dhe Xibrin në nivelet më ta larta.

Në drejtim të shërbimit të transportit, i gjithi organizohet nga furgona dhe autobuza privat, dhe sipas intervistave tona në dy vitet e fundit informaliteti në sektor (shërbim i pa licencuar) **është më shumë se 35%¹**.

¹ Nga krahasimi i numrit të licencave të lëshuara në 2011, 2012, 2013 mund të dallohet një rënie në nivelin e të ardhurave nga tarifat për secilës NJQV, kjo shifër shkon në zero për disa NJQV si Gurra and Klosi.

Kur marrim parasysh nevojat e popullsisë dhe aktivitetet ekonomike të ZF, veçanërisht bujqësinë dhe turizmin, siç u shpjeguan në seksionin e analizës ekonomike, për rrugë rurale të përshtatshme, për të akesuar tregjet rajonale dhe kombëtar, konsideratat kryesore të vendimmarrjes dhe veprimit të politikave, do të jetë si më poshtë:

Drejtimi i Politikave 1 dhe veprimi i Autoriteteve publike: NjQV-të kanë nevojë të sigurojnë fonde të mjaftueshme për të përmirësuar cilësinë e rrugëve rurale dhe për të mundësuar tranzicionin nga gjendje e keqe në të mirë. Përveç, shtrimi i rrugëve të pashtuara veçanërisht i asaj rajonale duhet të adresohet në afatmesme. Sipas etapave të specifikuara ne Aneksin Nr. ... të këtij dokumenti, edhe pse nuk ka fonde të mjaftueshme për të mbuluar mirëmbajtjen e rrugëve lokale **ekziston një hendek në financim prej rreth ALL 35 milionë në vit**, minimalisht (referojuni Figurës 40 me poshtë), për investimet e reja dhe mirëmbajtjen e rrugëve rajonale. Alternativat për mbushjen e hendekut të financimit do të ishin:




Figura 34: Nevoja për investime dhe mirëmbajtje në nivelin rajonal dhe në minimum e nën supozimve nën minimum dhe normale të etapave (mirëmbajtje parciale në minimum – mbushja e gropave dhe nivelimi, mirëmbajtja minimale dhe korrektimi i carjeve, nivelimit të sipërfaqeve dhe mbushjeve etj.)
Burimi: Llogaritjet e autorit bazuar në informacionin e marrë nga zyrtarët e ZF.

- Në periudhë afatmesme deri në afatgjatë do të arrihet rritja e investimeve nga entitetet e ZF në rrjetet rajonale nxitur nga kursimet e shkrirjes së NJQV-ve të vogla në mën të mëdha. Këtu Reforma Administrative Territoriale përbën një hap në drejtimin e duhur. Në një skenar më pak optimist, kur të ardhurat janë më të ulta

se sa pritet, atëherë alternativa do të jetë skemat e bashkëpunimit midis NJQV-ve dhe PPP (partneriteti-publik-privat) për investime.

- Në afat mesëm hendeku rajonal i financimit për investimet mund të mbushet nga instrumenta si FSHZH ose mundësi të tjera që do të krijohen si një mekanizëm barazimi që do të shoqërojë reformën administrative territoriale.

Drejtimi i Politikave 1 dhe veprimi i Autoriteteve publike: Për momentin i gjithë shërbimi i transportit (lokal rural, rajonal, urban dhe interurban) ofrohet nga operatorë privatë përmes licencave të lëshuara nga NJQV-të përkatëse. Është e paqartë se si do të jetë në të ardhmen strategjia rajonale dhe kombëtare e transportit publik, dhe si do të prek NJQV-të e reja më të mëdha. Megjithatë krijimi i njësive më të mëdha (Klos dhe Burre) do të krijojë më shumë mundësi për optimizimin e të drejtave të licencave dhe operatorëve privatë, meqenëse do të ndiqen më shumë itinerate dhe do të shërbehet më shumë popullsi. Planifikimi i transportit në këto entitete të reja do të përbëjë një prej sfidave me të cilat do të përballen zyrtarët e rinj të ZF. Nuk ka zgjidhje të gatshme por një këshillë e mirë do të ishte ta mbanin thjeshtë (keep it simple (KIS)). Çdo entitet duhet të identifikoj fillimisht gjatësinë totale të rrugëve që do të jenë në strukturën e tij dhe nën përgjegjësinë e tij për t'u menaxhuan sipas qëllimit të tyre (akses në tregje, akses në arsim, akses në shëndetësi ose shërbime




Figura 35: Prezentim Skematik i Metodologjive të Transportit dhe Aksesit të Rrugëve

Burim: Dizajnimi dhe Vlerësimi i Infrastrukturës së Transportit Rural; Sigurimi i Aksesit Bazik për Komunitetet Rurale, Jerry Lebo, Dieter Schelling, Dokumenti Teknik I Bankës Botërore
Shënimet e Infrastrukturës, Transporti, Uji dhe Zhvillimi Urban, Banka Botërore 1999

administrative etj.). Do të bëhet e qartë se rrjeti lokal dhe Infrastruktura Rajonale e Transportit (IRT) e ZF pavarësisht totalit më të lartë ka trafikun më të ulët (këtu më poshtë të quajtur si sasia e Mjeteve në Ditë që mund të jenë Lloje të Transportit të Motorizuar ose Jo të Motorizuar) krahasuar me provincat ose rrjetet kombëtare.

Hapi i radhës do të jetë të planifikohet për aksesin bazë, të thjeshtë dhe të plotë të komuniteteve dhe të dizajnohet rrugëtimet lokale, të cilat mirëmbahen nga shërbimi privat ose nga ai publik. I rëndësishëm për të do të jetë vlerësimi i Thyerjeve të Rrugëve mbi bazën e kritereve subjektive ose objektive si:

- Sipërfaqja e rrugës
- Gropat
- Kthesat
- Çarjet
- Etj.

Maximum Speeds Function of Roughness (km/h)						Roughness (IRI)
Cars	Utilities	Buses	Light Trucks	Medium/Heavy Trucks	Articulated Trucks	
106	105	105	105	94	84	6
80	78	78	78	71	63	8
64	63	63	63	57	50	10
53	52	52	52	47	42	12
46	45	45	45	40	36	14
40	39	39	39	35	31	16
35	35	35	35	31	28	18
32	31	31	31	28	25	20

Figura 36: **Tablela e raporteve Thyerje/Shpejtësi të mjeteve**

Burimi: Shënimet e Infrastrukturës, Transporti, Uji dhe Zhvillimi Urban, Banka Botërore 1999

Bazuar në thyerjen e rrugëve, do të ndërtohet planifikimi i niveleve të ndryshme të shpejtësisë sipas niveleve respektive të thyerjeve të vlerësuara me koeficientet sipas figurës më sipër që i korrespondojnë teknologjive të makinave të përdorura në Shqipëri për mjetet e transportit privat, në fund të viteve '90 dhe në fillim të viteve 2000. Me të gjetur në këtë mënyrë shpejtësitë mesatare të llojeve të ndryshme të mjeteve, duke njohur distancat, të dhënat mesatare të trafikut, dhe nevojat e komunitetit, është e thjeshtë të **vlerësohen kostot e niveleve të ndryshme të transportit për të përcaktuar tarifat e licencave ose për të buxhetuar mirëmbajtjen dhe investimet** në rrugët lokale për 5 deri në 10 vitet e ardhshme.

Në përgjithësi potencialet e larta të përfitimeve të ekonomive të shkallës për operatorët privat pritet të kompensojnë kosto të rritura të standardeve të larta për shërbimet e transportit nga NJQV-të e reja dhe rrugëtime shtesë dhe investime nëse është e nevojshme; prandaj nevojat për lëvizshmëri cilësore dhe shërbime transporti të favorshëm për perspektivat e zhvillimit në ZF do të trajtohen dhe do të plotësohen më mirë.

3.3 Menaxhimi i mbetjeve

Shërbimi i menaxhimi të mbetjeve në NJQV pjesë e ZF në të ardhmen, është i ngjashëm me shërbimin e ofruar nga këto NJQV për menaxhimin e sistemit të ujërave të zeza.




Figura 37: Harta e shërbimit të mbetjeve në ZF

Vetëm bashkia **Burrel** ofron mundësin e **mbulimit të plotë** të popullsisë me këtë shërbimin; Bashkia Klos mbulon vetëm 30% të popullsisë, komuna Ulëz 50% dhe komuna Suç 80% të sipërfaqes totale të banuara si ajo e treguar në hartën në të majtë. Shërbimi përfshin të dyja mbetjet urbane dhe mbetjet inerte. Në tre prej tyre shërbim realizohet nga **nënkontraktorët private** duke përdorur kazanë metalikë për mbeturina në rastin e Burrelit dhe Klosit dhe për komunën Suç në formën e venddepozitimi prej betoni

Burreli dhe Klosi mbledhin tarifat e pastrimit nga banorët në mënyrë që të financojnë këtë shërbim;

- Burrel është përgjegjës të mbledh **788** dhe Ulëza **800 lekë /banor /vit**.
- Klos **500 lekë/banor /vit**. Bizneset janë të detyruar të paguajnë 40% më shumë për të treja këto NJQV. Komuna Suç nuk është ngarkuar me asnjë tarif për financimin e këtij shërbimi. Në rastin e Klosit bizneset e vogla janë detyruar të paguajnë 14 herë më shumë dhe ndërsa për bizneset e mëdha është 240 herë më shumë.

Në të gjitha NJQV-ve e tjera, familjarët janë përgjegjës për mbeturinat që prodhohen prej tyre. Si rregull i përgjithshëm në ZF çfarë është mbetje organike kompostohet, por ende asnjë nga NJQV nuk saktëson ndonjë përgjigje të saktë në lidhje me shtrirjen e këtij aktiviteti të riciklimit, i cili si i tillë kryhet në mënyrë informale. Pjesa tjetër e mbetjeve i'u lihet banorëve në vullnetin e tyre të lirë.

E njëjta gjë po ndodh edhe me mbeturinat inerte. Është e vetëkuptueshme se nuk ka ndarje apo klasifikim të mbeturinave dhe kjo është e vërtetë jo vetëm për mbeturinat urbane por edhe për mbeturinat industriale dhe ato spitalore. Bashkia Burrel për shembull nuk kryen ndarjen e mbetjeve spitalore nga mbetjet urbane, kështu që nuk dihet saktë sasia e mbetjeve e të dy këtyre grupeve. E njëjta gjë është e vërtetë për

të dy bashkitë Burrel dhe Klos.Nuk ka statistika të rregullta mbi mbetjet inerte të ndara në mbetje inerte industriale dhe urbane.

Siç dhe e kemi përmendur norma e mbledhjes së tarifës në bashkinë Burrel është 60% dhe në Klos vetëm 30%. Bashkia Klos mbledh pothuajse 100% tarifat nga bizneset. Duke pasur parasysh pamjaftueshmërinë e të dhënave të besueshme e vetmja alternativë është për të drejtuar një model simulimi bazuar në metodologjinë e DLDP për planifikimin e tarifave të mbeturinave / banor / vit sipas supozimeve të mëposhtme:

- Burreli është konsideruar të jetë një zonë urbane, pra, sasia e mbeturinave për banor në ditë supozuar të jetë 0,75 kg në ditë. Frekuenca e shërbimit supozohet të jetë 7 herë / javë
- Klos dhe të gjitha zonat e tjera janë konsideruar të jenë rural në intervalin 0,2-0,3 kg / banor në ditë, Klos ka vlerën më të lartë nga të gjithë me një frekuencë shërbimi që supozohet të jetë prej 2 herë / javë
- Supozimet për distancat që mbulohen janë llogaritur bazuar në të dhënat e sipërfaqes së përgjithshme si dyfishi i rrënjës katrore të sipërfaqes në m² dhe distanca (hipotetike) e vend-depozitimit është konsideruar të jetë midis 2-5 km

Rezultatet e simulimit ndërmjet entiteteve të ndryshme japin vlerat e paraqitura në grafikun e mëposhtëm për të dy kosto për ton dhe për banor në vit;




Figure 38: Cost in ALL per inhabitant/year (on the left axe) and per Ton/Year (on the right axes)

Sources: Simulation of tariffs based on Dldp model for calculating cost per unit and the level of tariff of Waste service

Note: The cost include all costs of waste collection and depositing activity but cost of Lanfield as there is not one in the area and as such it's cost are for the moment unknown.

Përfundimet që mund të nxirren mund të shërbejnë gjithashtu edhe si rekomandim, për drejtimin e politikave dhe veprimeve që mund të ndjekin zyrtarët e ardhshëm të ZF si më poshtë:

Gjetje dhe Rekomandim 1: Në të dy rastet e bashkive Burrel dhe Klos tarifa duket e mjaftueshme për të mbuluar shpenzimet administrative dhe ato operacionale të aktivitetit të grumbullimit të mbetjeve të dyja NJQV duhet të arrijnë të mbledhin tarifën në masën 100%.

Gjetje dhe Rekomandimi 2: Prija është më e lartë, popullsia i shërbehet në nivel të ulët dhe kjo është kostoja që penalizon komunën Ulëz, në dritën e të paturit një nivel më të lartë të tarifave se Burreli dhe Kosi. E njëjta gjë vlen edhe për çdo NJQV tjetër që ka nivel të ulët të popullsisë. Kjo do të thotë se ka një argument të fortë në favor të bashkëpunimit mes zonave të banuara në këtë ZF, për krijimin e marrëveshjeve për menaxhim dhe mbledhjen e mbeturinave si aktivitet në tërësi.

Kjo gjetje është përsëritur jo vetëm për këtë shërbim publik por edhe për furnizimin me ujë dhe sistemin e ujërave të zeza, transportin dhe mirëmbajtjen e rrugëve. Në mund të theksojmë se **procesi i reformës administrative- territoriale është një lëvizje në drejtimin e duhur** megjithatë hapat e **nevojshëm të reformës duhet të perditesohen me informacionin përkatës dhe korrekt.**

Gjetje dhe Rekomandimi 3: Simulimi i mësipërm ka një mangësi; ajo nuk përfshin koston e tokës. Kjo është një mangësi që mund të demtojë miratimin e dy rekomandimeve të mëparshme sepse dëmi i shkaktuar nga mbeturinat e krijuara dhe të pamenaxhuara është i pallogatitshëm. Të dhënat e mbledhura nga ekipet në

	Burrel	Klos	Komsi
Inert Urban Waste Ton	210	400	1200
Inert Waste from Mines m ³			751,700
			1,653,740


Table 8: Sasia e Mbetjeve në Ton

Burimi: intervista me zyrtar publik lokal dhe gjetjet e grupit përgjegjës për menaxhimin e mbetjeve strategjia rajonale 2013

përgjegjësi të zyrtarëve të ardhshëm publike të ZF. Nxjerrja dhe aktivitetet e përpunimit të mineraleve janë në diskrecionin e aktiviteteve kombëtare dhe gjithashtu organeve rajonale.

terren në funksion të strategjisë së mjedisit në nivel rajonal për Dibrën në lidhje me sasinë e mbeturinave industriale dhe minerale në rajonin e Matit jepen në tabelën në të majtë. Menaxhimi në nivele të tilla i mbeturinave **shkon përtej**

Në anën tjetër të dhenat tregojnë se vend-depozitimet kanë kosto shumë më të larta se mundësit e ofruara brenda kufijve të ZF sipas studimit (jo më shumë se 60.000 banorë). Të dhënat tregojnë se një vend-depozitim duhet të ndërtohet në mënyrë të tillë që ai t'i shërbejë nevojave jo vetëm të Matit, ZF por edhe për Dibren dhe më gjerë, në mënyrë që të shfrytëzojnë përfitimet në shkallë të



plotë. Për më tepër, ky **perfundim është një argument i fortë në favor**

të skemave të bashkëpunimit në këtë fushë jo vetëm ndërmjet NJQV-ve në Mat, ZF por dhe përtej zonës së tyre.

Figure 39: Economies of scale levels for operating costs of land-field

Source: Findings of responsible group team for Dibra regional waste management strategy, 2013.

4. Analiza Organizative e Njësive në FA Klos, Burrel

4.1 Analiza e Strukturave Organizative.

Strukturat organizative të njësive të qeverisjes lokale aktuale janë uniforme përveç Bashkisë Burrel ku dhue numri i zyrtarëve publikë lokalë është më i madh. Në figurën




Figure 40 : Struktura organizative e Bashkisë Burrel dhe Struktura Organizative e Bashkisë Klos dhe e njësive të tjera ekzistuese e ilustruar këtu me strukturën organizative të NJQV Ulëz.

Burimi ; Të dhëna nga Kryetarët e njësive vendore .

e mësipërme struktura organizative e Bashkisë Burrel paraqitet në krah të majtë kurse në krah të djathtë jepet struktura e njësive organizative e njësive të tjera përfshirë dhe Klosin.

Ajo që mund të vihet re është një strukturë tipike vertikale ku roli i Kryetarëve të bashkisë apo Komunës është i pazëvendësueshëm në kuptimin që kryetarët e njësive bashkiake kanë jo vetëm autoritetin kryesor të vendimarrjes por edhe përgjegjësinë për drejtimin e përditshëm për shumicën e funksioneve të qeverisjes në nivelin vendor. Kjo situatë duket se favorizohet nga madhësia e vogël e njësive të qeverisjes vendore gje që nuk pritet të ndryshojë me shkrirjen e njësive ekzistuese në njësi më të mëdha. Nënkuptohet që ky ndryshim pritet të rrisë më tepër **domosdoshmërinë e organigramave më funksionale dhe rolin e nënkryetarëve** në krye të drejtimit të përditshëm të këtyre ndarjeve funksionale.

Në terma të burimeve njerëzore në kushtet kur të gjitha strukturat organizative janë të ngjashme ajo që mund të sigurojë kursime në burime **është inxhinieringu i shërbimeve në nivel lokal me tipet e projekteve** të Zyrave të shërbimeve me një

ndalesë. Të tilla shërbime që mund të përfitonin nga kjo mënyrë e re e ofrimit të shërbimeve do të ishin :

- Shërbimi i gjëndjes civile,
- Shërbimi i arkivave
- Shërbimi i sektorit të të ardhurave sidomos ai që lidhet me faturimin e shërbimeve të ujësjellësit dhe kanalizimeve, pastrimit dhe gjelbërimit. ë
- Shërbimi i lejeve dhe liçensave
- Shërbimi i urbanistikës

Kursimet në burime njerëzore të llogaritura do të ishin në nivelin **10-25%** në nivel total gjithnjë duke garantuar cilësinë e shërbimit¹. Megjithatë rekomandohet që kursimet në

NJQV	Totali i Zyrtarëve Lokalë Publike	burimet njerëzore nga procesi i shkrirjes së NJQV të shkojë paralelisht me procesin e projekteve të zhvillimit në FA në menyrë që të garantohet punësimi i burimeve njerëzore të lira dhe cilësia e ofertës së punës në këto zona. Si aktivitete të tilla fare mirë mund të shërbenin aktivitetet e shërbimeve ose turizmit, shoqatat e fermerëve dhe operatorëve të shërbimeve. Keto projekte, një pjesë e të cilave paraqiten dhe në seksionin e projekteve të këtij materiali do të duhet të mbështeten me një program intensiv trainimi për të bërë të mundur punësimin në kushte dhe aktivitetet e reja. Një mundësi tjetër punësimi do të ish zgjerimi i ofertës së shërbimeve në nivel lokal që synohet në strategjinë e re të ndihmës dhe përkrahjes sociale 2013-2020. Kjo do të thotë që përveç shërbimit të përkrahjes sociale shërbime të tjera që mund të ofrohen në nivel lokal nëpërmjet mekanizmit të transfertave të kushtëzuara do të ishin dhe ai i kujdesit për jetimët, moshën e thyer, tetrapelgjikët dhe invalidët etj. Deri tani këto shërbime janë mbuluar nëpërmjet të tretëve. Në të ardhmen dhe me strategjinë e re synohet që shërbime të tilla të institucionalizohen në struktura të qeverisjes vendore.
Burrel	130	burimet njerëzore nga procesi i shkrirjes së NJQV të shkojë paralelisht me procesin e projekteve të zhvillimit në FA në menyrë që të garantohet punësimi i burimeve njerëzore të lira dhe cilësia e ofertës së punës në këto zona. Si aktivitete të tilla fare mirë mund të shërbenin aktivitetet e shërbimeve ose turizmit, shoqatat e fermerëve dhe operatorëve të shërbimeve. Keto projekte, një pjesë e të cilave paraqiten dhe në seksionin e projekteve të këtij materiali do të duhet të mbështeten me një program intensiv trainimi për të bërë të mundur punësimin në kushte dhe aktivitetet e reja. Një mundësi tjetër punësimi do të ish zgjerimi i ofertës së shërbimeve në nivel lokal që synohet në strategjinë e re të ndihmës dhe përkrahjes sociale 2013-2020. Kjo do të thotë që përveç shërbimit të përkrahjes sociale shërbime të tjera që mund të ofrohen në nivel lokal nëpërmjet mekanizmit të transfertave të kushtëzuara do të ishin dhe ai i kujdesit për jetimët, moshën e thyer, tetrapelgjikët dhe invalidët etj. Deri tani këto shërbime janë mbuluar nëpërmjet të tretëve. Në të ardhmen dhe me strategjinë e re synohet që shërbime të tilla të institucionalizohen në struktura të qeverisjes vendore.
Klos	29	
Baz	13	
Derjan	10	
Macukull	12	
Rukaj	9	
Suç	9	
Ulëz	9	
Xibër	12	
Total	233	

Table 1 : Numri aktual i zyrtarëve publik lokalë

shërbimeve në nivel lokal që synohet në strategjinë e re të ndihmës dhe përkrahjes sociale 2013-2020. Kjo do të thotë që përveç shërbimit të përkrahjes sociale shërbime të tjera që mund të ofrohen në nivel lokal nëpërmjet mekanizmit të transfertave të kushtëzuara do të ishin dhe ai i **kujdesit për jetimët, moshën e thyer, tetrapelgjikët dhe invalidët** etj. Deri tani këto shërbime janë mbuluar nëpërmjet të tretëve. Në të ardhmen dhe me strategjinë e re synohet që shërbime të tilla të institucionalizohen në struktura të qeverisjes vendore.

Riorganizimi i shërbimeve të ujësjellës kanalizime dhe mbetjeve nëpërmjet bashkpunimit të njërive vendore apo ofrimit të shërbimeve në teritore më të mëdha për të përfutur nga ekonomitë e shkallës **nuk ka mundësi të sjellë një kursime** të mëdha në burime njerëzore për aq kohë sa punësimi në këto shërbime në nivel komunal është shumë i ulët ose joekzistent².

¹ Duke llogaritur kursimin me një person për çdo zyrë në nivel komune përgjegjës për këto shërbime për 10 komuna të shkrira në njësitë e ardhshme Mat dhe Klos do të arrijmë në një kursim total jo më pak se 50 zyrtarë publikë një kursim deri në 25% të numrit të përgjithshëm të zyrtarëve publikë aktualë.

² Shumica e ujësjellësave në komunat e ZF janë me rrjedhje të lirë si pasojë të punësuarit në komuna për këtë shërbim janë ose të ngarkuar me faturimin ose me kontrollin e linjave dhe instalimeve. Në rast shkrirje në njësi më të

4.2 Funkcionet e Pushtetit Lokal dhe Programi i FA

Funkcionet aktuale të qeverisjes vendore në FA Burrel, Klos ndjekin përgjithsisht modelin e funksioneve në territoret e tjera të vendit. Në mënyrë të përmblodhur ato janë :

- Shërbimet e përgjithshme qeveritare
- Arsimi
- Shëndetsia
- Shërbimet Sociale
- Shërbimet Lokale (Ruajtje, Administrim dhe Planifikim Teritori, Pastrim gjelbërim, Mbledhje dhe Manaxhim Mbetjesh, Ujësjellës dhe Kanalizime, Rrugë)
- Gjendja Civile
- Zhvillimi Ekonomik

Megjithatë nga analiza e shërbimeve në nivel lokal vihet re që disa prej **shërbimeve që duhet të ekzistojnë në nivel lokal janë inekzistente** ose mbulojnë në mënyrë të pamjaftueshme banorët e ZF. Më konkretisht shërbimi i mbledhjes dhe manaxhimit të mbeturinave ofrohet vetëm në Burrel, Klos, Ulëz dhe Suç, shërbimi i ujësjellës kanalizimeve ofrohet në një shkallë më të ulët se mesatarja e vendit pavarësisht faktit se zona e Matit është e pasur me burime ujore. Arsyeet kanë të bëjnë së pari me **paaftësinë e NJQV lokale për të rritur masën e të ardhurave lokale** për të mbuluar shpenzimet¹ që nevojiten për të siguruar. Kjo paaftësi është dhe në burim të pamundësisë për të planifikuar në afat të mesëm ose afatgjatë përtej nivelit të shpenzimeve operative. Kursimi i shpenzimeve operative si pasojë e kursimeve të përshkruara në seksionin e mëparshëm do të krijojë perspektiva më të mirë për planifikim buxhetor afatmesëm dhe afatgjatë. Të dyja këto zhvillime në të ardhmen do të lehtësoheshin nëse zyrtarët lokalë do të kishin aftësitë e duhura në planifikimin strategjik dhe në planifikimin buxhetor afatmesëm. Aktualisht këto aftësi mungojnë dhe rrjedhimisht rekomandohet që programet e tranimit të administratës publike lokale në të ardhme të përqëndrohen dhe në këto drejtime.

mëdha të ofrimit të shërbimit, burimet njerëzore të punësura me kontrollin dhe matjen e konsumit do të duhet të jenë përsëri të angazhuara në këto qendra lokale kurse kursimet nga shërbimet e Faturimit janë përllogaritur në inxhinieringun e shërbimeve me projektin e ZMNJN. Për shërbimin e mbledhjes dhe manaxhimit të zonave urbane ky shërbim nuk ofrohet pothuajse fare në NJQV aktuale me përjashtim të Burrelit, Klosit, Ulëz dhe Suç.

¹ Nga konsultimet me NJQV shifrat e planifikuara të buxhetit asnjëherë nuk janë realizuar në nivel NJQV për të gjitha njësitë.

5. Projekte të Zhvillimit të FA.

5.1 Baza metodologjike për përzgjedhjen dhe propozimin e projekteve

Në konceptimin e projekteve të zhvillimit të ardhshëm të FA, grupi i punës është mbështetur në analizën ekonomike dhe të shërbimeve dhe në kombinimin e veprimeve të aktorëve publikë dhe privatë për të adresuar mangësitë ose përfituar nga shanset për zhvillim të FA mbi bazën e avantazheve konkurruese të identifikuara në seksionet e analizës funksionale ekonomike dhe të shërbimeve.

Qëllimi i këtyre projekteve është që të realizohet një vizion i zhvillimit të ZF i cili megjithse pritët të identifikohet ende në kohën e zgjedhjes së zyrtarëve publikë vendorë të njësive të reja do duhet të përfshinte me doemos ;

- Rritjen e mbulimit të popullatës së rajoneve me shërbime publike më efektive (si pasojë e ekonomive të shkallës) dhe cilësore.
- Garantimin e ruajtjes së nivelit aktual të ofertës së shërbimeve publike pavarësisht shkrirjes së NJQV aktuale në njësi më të mëdha vendore.
- Zhvillimin ekonomik dhe të qëndrueshëm në FA nëpërmjet shfrytëzimit të avantazheve krahasuese të identifikuara.
- Respekt i ambientit, kulturës dhe traditës lokale

Skematikisht problematika dhe tipologjia e projekteve do të paraqiteshin si më poshtë :




Figure 41 : Paraqitje Skematike e Tipologjisë së projekteve të hartuara nga konsulentët

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	<i>Zyra e Shërbimeve me Një Ndalesë -ZSHNJN (Bashkia Mat)</i>
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Burrel, Koms, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan,</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	<i>Për tu Përcaktuar por jo më Jo më pak se 25,000,000 lekë</i>

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrija dhe amalgimi i njesive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhjeve bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Aktualisht shërbimet publike në Burrel ofrohen me sistemin e OSSH. Ky sistem duhet të shtrihet dhe të integrohet me njësitë e tjera që do shkrihen me bashkinë e Burrelit konkretisht *Koms, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan*. Kjo është më e rëndësishme sidomos për shërbimet e mbështetjes së zhvillimit ekonomik (dhënie licensash, lelesh për ushtrim aktiviteti, pagime tarifash dhe taksash lokale, planifikimi urban, mirëmbajtja e pyjeve etj) si dhe shërbime të tjera të karakterit administrativ (gjëndja civile, përkrahja sociale) etj. Ofrimi i shërbimeve me një zyrë mbështetëse dhe disa zyra pararojë në secilen nga njësitë shkrija do të rrisë efektivitetin e shërbimit duke ruajtur shkallën e shërbimit të arritur.

3. Objektivat Specifike të Projektit

ZSHNJN do të sigurojë shërbimet publike në zonat e shkrija në mënyrë më efektive dhe me cilësi më të lartë duke rritur transparencën e publikut. .

4. Rezultatet e Pritura dhe Indikatoret e Projektit

- Rritja e efektivitetit të shërbimeve publike për qytetarët e bashkisë Mat: total i popullsisë më tepër se 27000 banorë,
- Zvogëlimi i kostos së shërbimeve publike për banorë si pasojë e zvogëlimit të kostos së personelit dhe të kohës së harxhuar për njësi shërbimi (më tepër se 30%)
- Rritjen e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet futjes së praktikës së shërbimeve të hapura (100%)

5. Aktivitetet e Projektit

- Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN
- Rinovimi dhe adaptimi i ambjentit ZSHNJN
- Kompletimi i ZSHNJN Pajisjet bazë

- ZSHNJN, Punësim personeli, trajnimi dhe testimi
- Zhvillimi i materialeve promocionale (ZSHNJN logo, shenja, fletushka, kuti postare për qytetarët, komentet dhe ankesat).

6. Maturiteti i Projektit

Ka një praktikë ekzistuese në bashkinë e Burrelit e cila duhet të shtrihet në bashkitë e tjera që do të shkrihen në kuadrin e njësisë së re Mat.

Ekziston një projekt pilot i zhvilluar nga program Dldp për njësinë Lezh, Kallmet që mund të zbatohet në këto zona.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferta e Pakushtëzuar
- Donatorët
- Fond i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE

8. Kosto e Projektit

Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN	
Rinovimi dhe adaptimi i ambjentit ZSHNJN	
Kompletimi i ZSHNJN Pajisjet bazë	
ZSHNJN, Punësim personeli, trajnimi dhe testimi	
Zhvillimi i materialeve promocionale (ZSHNJN logo, shenja, fletushka, kuti postare për qytetarët, komentet dhe ankesat)	
Total:	Jo më pak se 25,000,000 lekë

PROJEKTI 2

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	<i>Zyra e Shërbimeve me Një Ndalesë -ZSHNJN (Bashkia Klos)</i>
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Klos, Suç, Xibër, Gurrë</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	<i>Për tu Percaktuar por jo më Jo më pak se 13,000,000 lekë</i>

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njesive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhjeve bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Aktualisht nuk ka asnjë praktikë të shërbimeve të këtij lloji në komunat që duhet të shkrihen kështu që duhet nisur nga e para. Kjo është më e rëndësishme sidomos për shërbimet e mbështetjes së zhvillimit ekonomik (dhënie licensash, lejesh për ushtrim aktiviteti, pagime tarifash dhe taksash lokale, planifikimi urban, mirëmbajtja e pyjeve etj) si dhe shërbime të tjera të karakterit administrativ (gjëndja civile, përkrahja sociale) etj. Ofrimi i shërbimeve me një zyrë mbështetëse dhe disa zyra pararojë në secilen nga njësitë shkrira do të risë efektivitetin e shërbimit duke ruajtur shkallën e shërbimit të arritur.

3. Objektivat Specifike të Projektit

ZSHNJN do të sigurojë shërbimet publike në zonat e shkrira në mënyrë më efektive dhe me cilësi më të lartë duke rritur transparencën e publikut. .

4. Rezultated e Pritura dhe Indikatore të Projektit

- Rritja e efektivitetit të shërbimeve publike për qytetarët e bashkisë Klos: total i popullsisë më tepër se 16000 banorë,
- Zvogëlimi i kostos së shërbimeve publike për banorë si pasojë e zvogëlimit të kostos së personelit dhe të kohës së harxhuar për njësi shërbimi (më tepër se 30%)
- Rritjen e transparencës dhe cilësisë së shërbimeve publike nëpërmjet futjes së praktikës së shërbimeve të hapura (100%)

5. Aktivitetet e Projektit

- Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN
- Rinovimi dhe adaptimi i ambjentit ZSHNJN
- Kompletimi i ZSHNJN Pajisjet bazë
- ZSHNJN, Punësim personeli, trajnimi dhe testimi

- Zhvillimi i materialeve promionale (ZSHNJN logo, shenja, fletushka, kuti postare për qytetarët, komentet dhe ankesat).

6. Maturiteti i Projektit

Aktualisht nuk ka asnjë praktikë të shërbimeve të këtij lloji në komunat që duhet të shkrihen kështu që duhet nisur nga e para.

Ekziston një projekt pilot i zhvilluar nga program Dldp për njësinë Lezh, Kallmet që mund të zbatohet në këto zona.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferta e Pakushtëzuar
- Donatorët
- Fond i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Klos
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE

8. Kosto e Projektit

Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një ZSHNJN	
Rinovimi dhe adaptimi i ambientit ZSHNJN	
Kompletimi i ZSHNJN Pajisjet bazë	
ZSHNJN, Punësim personeli, trajnimi dhe testimi	
Zhvillimi i materialeve promionale (ZSHNJN logo, shenja, fletushka, kuti postare për qytetarët, komentet dhe ankesat)	
Total:	Jo më pak se 13,000,000 lekë

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	<i>Krijimi i Zyres së Arkivave dhe Bazës së të dhënave për bashkinë Mat dhe Klos</i>
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Bashkia Mat dhe Klos,</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	4,000,000 lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njësive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhjeve bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Pavarësisht mënyrës së ofrimit të shërbimeve publike informacioni mbështetës (regjistra popullsie, asete, tatimpagues, biznese etj) duhet të jetë i integruar dhe kjo nënkupton integrimin e arkivave fizike në njësitë e reja që do të krijohen nga bashkimi i njësive ekzistuese dhe të bazave të të dhënave dhe krijimin e bazave të të dhënave të integruara fizike dhe elektronike për të dy njësitë bashkiake Mat dhe Klos. Kjo nënkupton po ashtu dhe instalimin e një sistemi informacioni të brëndshëm të përdorur për mirembajtjen dhe aksesin në këto të dhëna nga njësitë e shërbimeve.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Krijimi i bazave të të dhënave të integruara të të dhënave fizike dhe elektronike për njësitë e Bashkisë Klos dhe Mat.

4. Rezultatet e Pritura dhe Indikatore të Projektit

- Krijimi i bazës së të dhënave fizike dhe elektronike për njësitë bashkiake Mat dhe Klos (Zyrat e Arkivave Qëndrore dhe lokale, Sistemi i Klasifikimit dhe Formatit leter, elektronik dhe fotografik, Dosjet dhe Raftet, Ndriçimi dhe Ruajtja e regjistrave, Manuali i aksesit dhe transferimeve të të dhënave)
- Konceptimi i arkitekturës dhe skemës së përdorimit të të dhënave nga njësitë e shërbimeve (Serverat Qendrore, Serverat lokalë, Koha e migrimit të të dhënave dhe formati)
- Zgjedhja e software dhe e licensave për përdorimin e të dhënave nga njësitë e shërbimeve (open source apo sistem i thjeshtë i bazës së të dhënave Access apo My SQL)
- Trainimi i personelit dhe krijimi i manualeve për përdorimin e të dhënave (Nga një kurs trainimi për njësi të shkrirë dhe një manual të përbashkët trainimi)

5. Aktivitetet e Projektit

- Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një Arkivave të integruara,
- Studimi dhe përzgjedhja e Konceptit,
- Tenderimi dhe zgjedhja e kompanisë zbatuese
- Rinovimi dhe adaptimi i ambienteve, pajisje kundër zjarrit dhe lagështisë

- Blerja e pajisjeve: Servera dhe liçensat e përdorimit, makina fotokopjuese me skanera të integruara, Dosje, Rafte, pajisje ajrimi për arkivat,
- Instalimi i programit të shfrytëzimit të të dhënave dhe sistemit të përdorimit të brëndshëm
- Zhvillimi i Manualeve të përdorimit
- Punësim personeli, trajnimi dhe testimi

6. Maturiteti i Projektit

Nuk ka një studim fillestar. Do të duhet të adaptohen studime paraprake nga njësi të tjera vendore të asistuar nga njësi më të përparuara të qeverisjes lokale

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferta e Pakushtëzuar
- Donatorët
- Fond i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- AKSH
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE

8. Kosto e Projektit për Bashkitë Mat, Klos dhe të gjitha njësitë që do të shkrihen

• Prezantim i konceptit dhe përfitimet e një Arkivave të integruara, • Studimi dhe përzgjedhja e Konceptit, • Tenderimi dhe zgjedhja e kompanisë zbatuese	500,000
• Rinovimi dhe adaptimi i ambjenteve, pajisje kundër zjarrit dhe lagështisë • Blerja e pajisjeve: Servera dhe liçensat e përdorimit, makina fotokopjuese me skanera të integruara, Dosje, Rafte, pajisje ajrimi për arkivat	3,000,000
• Instalimi i programit të shfrytëzimit të të dhënave dhe sistemit të përdorimit të brëndshëm • Zhvillimi i Manualeve të përdorimit	500,000
Punësim personeli, trajnimi dhe testimi	Të përfshira në zërin e mësipërm
Total:	4,000,000 lekë

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Krijimi i Faqeve të Internetit të Njësive Bashkiake Mat Klos
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Bashkia Mat dhe Klos,</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	1,000,000 lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njësive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritët të jetë një prej rrjedhjeve bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Krijimi i faqeve të Internetit për aksesin në kohë reale të informacionit mbi shërbimet publike, kostot dhe rezultatet e organeve të pushtetit lokal do të rriste transparencën dhe efektivitetin e këtyre shërbimeve. Keto faqe mund të depozitoheshin dhe të mirëmbaheshin nga serverat qëndrorë që do të krijoheshin nga sistemi i integruar i të dhënave sipas fishës së projektit Nr. 3.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Krijimi i Faqeve të Internetit të Bashkisë Mat dhe Klos dhe mirëmbajtja e tyre me informacion të përditësuar mbi shërbimet publike

4. Rezultatet e Pritura dhe Indikatore të Projektit

- Krijimi i faqeve të Internetit për bashkinë Mat dhe Klos (Faqe efektive me komunikim direkt me serverat qëndrore të këtyre bashkive)
- Informacion i përditësuar në Faqet e Internetit të Bashkive (Shërbimet publike të ofruara, Taksat, tarifat, licensat, burimet turistike, aktivitetet kulturore), rezultatet e aktiviteteve të zyrtarëve publikë Serverat lokalë, Koha e migrimit të të dhënave dhe formati)
- Rritja e transparencës dhe llogaridhënies së funksionarëve publikë lokalë (prezenca në site e planeve strategjike të zhvillimit ekonomik, plan buxheteve vjetore dhe afatmesme, raporteve tremujore, gjashtmujore të zbatimit të buxheteve, vendimet e këshillit bashkiak dhe planet e dëgjësive publike, rezultatet e prokurimeve dhe kontratave, rezultatet e auditimeve dhe zbatimet e rekomandimeve)

5. Aktivitetet e Projektit

- Prezantim i konceptit dhe formatit të faqeve të internetit
- Aprovimi dhe Zhvillimi i Kodit
- Trainimi i personelit mirëmbajtës
- Popullimi i Faqes së internetit dhe mirëmbajtja

6. Maturiteti i Projektit

Aktualisht Bashkia e Burrelit ka një sit funksional që duhet të pasurohet dhe të integrohet me njesitë e tjera që do t'i bashkohen këto site. Kodi dhe formati ekziston dhe behet fjale vetëm për pasurimin e tij.

Faqja e Internetit të Bashkisë Klos mund të zhvillohej me të njëjtin koncept dhe format duke minimizuar kostot

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit te Projektit.

Burimet e Financimit:

- Donatorët projekti Start
- Fond i Mbështetjes se Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat dhe Klos
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- AKSH
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE

8. Kosto e Projektit per Bashkitë Mat, Klos dhe të gjitha njesitë që do të shkrihen

Prezantim i konceptit dhe formatit të faqeve të internetit	0 (duke u nisur nga replikimi i faqes ekzistuese të Internetit të Burrelit)
Aprovimi dhe Zhvillimi i Kodit	20,000
Trainimi i personelit mirëmbajtës	20,000
Popullimi i Faqes së internetit dhe mirëmbajtja	Do të jenë pjesë e aktiviteteve të personave të punësuar me mirëmbajtjen e rrjetit të informacionit të brëndshëm
Total:	40,000 lekë

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	<i>Sherbimi i integruar i mbledhjes, grumbullimit dhe Manaxhimit të Mbetjeve Urbane (Bashkia Mat)</i>
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Burrel, Koms, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan,</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	900,000+ Pjesën e investimeve të specifikuar nga Studimi

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njësive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Sherbimi i mbledhjes së mbetjeve urbane është i organizuar aktualisht vetëm në Burrel (100% e popullatës) dhe Ulëz (50% e popullatës). Ish komunat e tjera nuk ofrojnë këtë shërbim, i cili është i nevojshëm për të përmirësuar cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe përmirësuar perspektivat e zhvillimit ekonomik për atë që ato janë të lidhura me cilësinë e një mjedisi më të pastër. Projekti ka një rëndësi të veçantë dhe për arsye se Burreli ka një spital rajonal, mbetjet e të cilit ende nuk trajtohen të ndara Krijimi i një sistemi të integruar të mbledhjes dhe manaxhimit të mbetjeve urbane mund të bëhet më cilësor dhe efektiv në kushtet e rritjes së sipërfaqes nën mbikqyrjen e Bashkisë Mat. Kostot e shërbimit do të ishin më të ulëta dhe për rrjedhojë dhe tarifën e shërbimit.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Krijimi i një sistemi të integruar të mbledhjes, grumbullimit dhe manaxhimit të mbetjeve urbane për qytetarët dhe banorët e Bashkisë Mat dhe të rrethinave

4. Rezultatet e Pritura dhe Indikatorët e Projektit

- Rritja e efektivitetit të shërbimit të mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve urbane për qytetarët e bashkisë Mat dhe rrethinave: (total i popullsisë më tepër se 27000 banorë, përqindja e mbulimit me shërbimin mbi 75% në fund të projektit)
- Krijimi i vënddepozitimeve cilësore për të gjitha territoret nën autoritetin e Bashkisë Mat (8 vënd/depozitime).
- Krijimi i një sistemi të llogaritjes së kostos së shërbimit të integruar (kosto për banor dhe pasojë tarifë e njëjtë për të gjithë banorët e mbuluar me shërbimin)
- Memorandum bashkpunimi me njësitë e tjera rajonale për krijimin e një landfield rajonal të përpunimit të mbetjeve.

5. Aktivitetet e Projektit

- Studimi për sistemin e integruar të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane në bashkinë e Matit dhe kostimi i komponentëve.
- Aprovimi në Këshillin Bashkiak dhe hapja e prokurimit për investimet dhe shërbimin. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga

Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak.

- Projekt Memorandumi i hartuar dhe i diskutuar për ndërtimin e landfillit rajonal të përpunimit të mbetjeve.
- Përzgjedhja e fituesit për investimin, kontraktimi dhe organizimi i shërbimit nga Bashkia ose nga nënkontraktori.
- Zhvillimi i materialeve promociionale për promovimin dhe modalitetet e shërbimit (fletëpalosje)

6. Maturiteti i Projektit

Ka një praktikë ekzistuese në bashkinë e Burrelit dhe Ulëzës për ofrimin e këtij shërbimi e cila duhet të shtrihet në bashkitë e tjera që do të shkrihen në kuadrin e njësisë së re Mat.

Ekziston një projekt pilot i zhvilluar nga programi Ddp për njësitë e qeverisje lokale Shkodër dhe Lezhë që mund të zhvillohet dhe zbatohet në këto zona.

Ka një projekt të suportuar nga BE në nivel rajonal për krijimin e landfillit (Qarku Dibër) i cili mund të lehtësojë procesin e përgatitjes dhe nënshkrimit të memorandumit të bashkimit me NJQV e tjera për të minimizuar kostot.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferta e Pakushtëzuar
- Të ardhurat e veta nga tarifa
- Donatorët
- Fond i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE, Berzh

8. Kosto e Projektit

Studimi për sistemin e integruar të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane në bashkinë e Matit dhe kostimi i komponentëve	800,000
Aprovimi në Këshillin Bashkiak dhe hapja e prokurimit për investimet dhe shërbimin. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak	0
Projekt Memorandumi i hartuar dhe i diskutuar për ndërtimin e landfillit rajonal të përpunimit të mbetjeve	0
Përzgjedhja e fituesit për investimin, kontraktimi dhe organizimi i shërbimit nga Bashkia ose nga nënkontraktori.	Kosto do të jetë definitive pas studimit

	dhe menyrës së zgjedhur për shërbimin
Zhvillimi i materialeve promociionale (2000 copë)	100,000
Total:	900,000+ Pjesën e investimeve të specifikuar nga Studimi

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	<i>Sherbimi i integruar i mbledhjes, grumbullimit dhe Manaxhimit të Mbetjeve Urbane (Bashkia Klos)</i>
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Klos, Suç, Xibër, Gurrë</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	900,000+ Pjesën e investimeve të specifikuar nga Studimi

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njesive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritët të jetë një prej rrjedhjeve bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Sherbimi i mbledhjes së mbetjeve urbane është i organizuar aktualisht vetëm në Klos (30% e popullatës) dhe Suç 80% e popullatës). Ish komunat e tjera nuk ofrojnë këtë shërbim, i cili është i nevojshëm për të përmirësuar cilësinë e jetesës së qytetarëve dhe përmirësuar perspektivat e zhvillimit ekonomik për atë sa ato janë të lidhura me cilësinë e një mjedisi më të pastër. Krijimi i një sistemi të integruar të mbledhjes dhe manaxhimit të mbetjeve urbane mund të bëhet më cilësor dhe efektiv në kushtet e rritjes së sipërfaqes nën mbikqyrjen e Bashkisë Klos. Kostot e shërbimit do të ishin më të ulëta dhe për rrjedhojë dhe tarifat e shërbimit.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Krijimi i një sistemi të integruar të mbledhjes, grumbullimit dhe manaxhimit të mbetjeve urbane për qytetarët dhe banorët e Bashkisë Klos dhe të rrethinave

4. Rezultatet e Pritura dhe Indikatore të Projektit

- Rritja e efektivitetit të shërbimit të mbledhjes dhe përpunimit të mbetjeve urbane për qytetarët e bashkisë Mat dhe rrethinave: (total i popullsisë më tepër se 16000 banorë, përqindja e mbulimit me shërbimin mbi 75% në fund të projektit)
- Krijimi i vënddepozitimeve cilësore për të gjitha territoret nën autoritetin e Bashkisë Klos (4 vend/depozitime).
- Krijimi i një sistemi të llogaritjes së kostos së shërbimit të integruar (kosto për banor dhe pasojë tarifë e njëjtë për të gjithë banorët e mbuluar me shërbimin)
- Memorandum bashkpunimi me njësitë e tjera rajonale për krijimin e një landfill rajonal të përpunimit të mbetjeve.

5. Aktivitetet e Projektit

- Studimi për sistemin e integruar të mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane në Bashkinë e Klosit dhe kostimi i komponentëve.
- Aprovimi në Këshillin Bashkiak dhe hapja e prokurimit për investimet dhe shërbimin. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak.

- Projekt Memorandumi i hartuar dhe i diskutuar per ndërtimin e landfill rajonal të përpunimit të mbetjeve.
- Përzgjedhja e fituesit për investimin, kontraktimi dhe organizimi i shërbimit nga Bashkia ose nga nënkontraktori.
- Zhvillimi i materialeve promocionale për promovimin dhe modalitetet e shërbimit(fletëpalosje)

6. Maturiteti i Projektit

Ka një praktikë ekzistuese në bashkinë e Klosit dhe Suç për ofrimin e këtij shërbimi e cila duhet të shtrihet në bashkitë e tjera që do të shkrihen ne kuadrin e njësisë së re Klos.

Ekziston një projekt pilot i zhvilluar nga program Dldp për njësitë e qeverisje lokale Shkodër dhe Lezhë që mund të zhvillohet dhe zbatohet në këto zona.

Ka një projekt të suportuar nga BE në nivel rajonal për krijimin e landfill (Qarku Dibër) i cili mund të lehtësojë procesin e përgatitjes dhe nënshkrimit të memorandumit të bashkunimit me NJQV e tjera për të minimizuar kostot.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit te Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Transferta e Pakushtëzuar
- Të ardhurat e veta nga tarifa
- Donatorët
- Fond i Mbështetjes se Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- Donatorë: UNDP, OSBE, BE, Berzh

8. Kosto e Projektit

Studimi për sistemin e integruar te mbledhjes dhe depozitimit të mbetjeve urbane në bashkinë e Matit dhe kostimi i komponentëve	800,000
Aprovimi në Këshillin Bashkiak dhe hapja e prokurimit për investimet dhe shërbimin. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak	0
Projekt Memorandumi i hartuar dhe i diskutuar per ndërtimin e landfill rajonal të përpunimit të mbetjeve	0
Përzgjedhja e fituesit për investimin, kontraktimi dhe organizimi i shërbimit nga Bashkia ose nga nënkontraktori.	Kosto do të jetë definitive pas studimit dhe menyrës së

	zgjedhur për shërbimin
Zhvillimi i materialeve promociionale (2000 copë)	100,000
Total:	900,000+ Pjesën e investimeve të specifikuar nga Studimi

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Riorganizimi dhe Zgjerimi i rrjetit të Ujësjellësit dhe i Kanalizimeve (Bashkia Klos)
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Klos, Suç, Xibër, Gurrë</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	900,000 lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njesive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Shërbimi i Ujësjellësit dhe Kanalizimeve të Ujrave të zeza në Bashkinë Klos mbulon vetëm pjesërisht popullatën kurse aksesit ndaj rrjetit të kanalizimeve është dhe më i ulët. Të dyja shërbimet janë të manaxhuara nga vetë komunat ku mbledhja e tarifave është në nivelin e 50%. Krijimi i një entiteti të ri si bashkia Klos bën të nevojshëm riorganizimin e shërbimeve dhe investimet shtesë për të rritur shkallën e shërbimit dhe nivelin e aksesit në këto dy shërbime bazë krahasimisht me nivelet kombëtare.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Riorganizimi i shërbimit të ujësjellës kanalizimeve dhe investimeve shtesë për të rritur aksesin e banorëve në nivele të krahasueshme (jo më pak se) me normat mesatare kombëtare të publikuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

4. Rezultated e Pritura (dhe Indikatore të Projektit)

- Riorganizimi i shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujrave të zeza për të përfshirë të gjitha njësitë e amalguara në një entitet të vetëm të shërbimit që u shërben gjithë banorëve: (një entitet shërbimi i organizuar si korporatë publike, total i popullsisë për tu shërbyer më tepër se 16000 banorë, përqindja e aksesit në rrjetin e ujësjellësave më tepër se 85% dhe për ujrën e zeza më tepër se 50%)
- Vendosja e tarifave unike të shërbimit për furnizimin me ujë dhe kanalet e ujrave të zeza në gjithë territorin e bashkisë Klos (Tarifa e publikuar dhe përfshirë në paketën fiskale të miratuar nga Bashkia Klos ose brënda taksës së gjelbërimit).
- Krijimi i një sistemi të llogaritjes së kostonë së shërbimit të integruar furnizim me ujë dhe rrjet kanalizime ujra të zeza (kosto për banor dhe pasojë tarifë e njëjtë për të gjithë banorët e mbuluar me shërbimin).
- Rritja e nivelit të arkëtimeve nga njësia e shërbimit (bilanci i veprimtarisë së njësive të shërbimit jonegativ).

- Investimet të reja për të përmirësuar aksesin e banorëve në këto shërbime të realizuara nga Bashkia Klos (plane dhe zbatim i projekteve të investimit nga Bashkia Klos).
- Investime për rritjen e efektivitetit të shërbimit dhe faturimit të shërbimit dhe pakësuar humbjet (investimet në aparate matëse, kalimi nga tarifimi mbi shume fikse në tarifë për m³).

5. Aktivitetet e Projektit

- Studimi për sistemin e shërbimit të integruar të ujesjellësit dhe ujrave të zeza dhe mënyrën e organizimit të entitetit të shërbimit (shoqeri aksionare apo bashkia).
- Rishikimi i planeve dhe projekteve të ish njësive për investime dhe kanalizime dhe krijimi i një plani të integruar të ketyre investimeve në kordinim me strukturën përgjegjëse në nivel qendror (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit)
- Harmonizimi i rregullores dhe statutit të njësisë që ofron shërbimin me ligjin mbi decentralizimin dhe financat lokale.
- Aprovimi në Këshillin Bashkiak e plan projekteve të investimeve dhe kërkesave për financim nga donatorë ose FSHZH apo Fondi Rajonal i Zhvillimit.
- Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak.
- Zhvillimi i materialeve promociionale për promovimin dhe modalitetet e shërbimit(fletëpalosje)

6. Maturiteti i Projektit

Aktualisht shërbimi i furnizimit me ujë në njësitë që do të bashkohen për formimin bashkisë Klos ofrohet nga bashkia ose komunat. Studimi pritët ta validojë ose të rekomandojë mënyrën e shërbimit nëpërmjet shoqërive aksionare.

Ekzistojnë shume plan projekte investimesh në zonë nga ish komunat apo bashkia Klos të cilat duhet të ripunohen për t'iu përshtatur realitetit të ri të punës të funksionimit të bashkisë Klos.

Ligji i ri Organik i Decentralizimit, Financave Lokale pritët të specifikojë kompetencat dhe mënyrën e organizimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve nga njësitë e qeverisjes vendore.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Transferta e Pakushtëzuara
- Të ardhurat e veta nga tarifa
- Donatorët
- Fond i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- Donatorë: BE, Berzh, Kwf

8. Kosto e Projektit

Studimi për sistemin e shërbimit të integruar të ujesjellësit dhe ujrave të zeza dhe mënyrën e organizimit të entitetit të shërbimit	800,000
Aprovimi në Këshillin Bashkiak dhe hapja e prokurimit për investimet dhe shërbimin. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak	0
Rishikimi i planeve dhe projekteve të ish njësive për investime dhe kanalizime dhe krijimi i një plani të integruar të ketyre investimeve në kordinim me strukturën përgjegjëse në nivel qendror (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit)	0
Harmonizimi i rregullores dhe statutit të njësisë që ofron shërbimin me ligjin mbi decentralizimin dhe financat lokale	0
Aprovimi në Këshillin Bashkiak e plan projekteve të investimeve dhe kërkesave për financim nga donatorë ose FSHZH apo Fondi Rajonal i Zhvillimit. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak.	0
Zhvillimi i materialeve promocionale (2000 copë)	100,000
Total:	900,000

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Riorganizimi dhe Zgjerimi i rrjetit të Ujësjellësit dhe i Kanalizimeve (Bashkia Mat)
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike</i>
Vendi i Projektit	<i>Burrel, Koms, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan,</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	900,000 lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dalë nga shkrija dhe amalgimi i njesive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Ruajtja e stadit të arritur në shërbimet aktuale dhe përmirsimi i mëtejshëm janë tendencat që duhet të ecin paralelisht. Shërbimi i Ujësjellësit dhe Kanalizimeve të Ujrave të zeza në Bashkinë Burrel është 100 % dhe për ujrën e zeza së paku 60% kurse për komunat e tjera aksesit i banorëve në skemat e furnizimit me këto shërbime është dhe më i ulët. Në qytetin e Burrelit shërbimi është i organizuar si shoqëri aksionere kurse në pjesën e mbetur të territorit të dyja shërbimet janë të manaxhuara nga vetë komunat ku mbledhja e tarifave është në nivelin e 50%. Krijimi i një entiteti të ri të zgjeruar si bashkia Burrel bën të nevojshëm riorganizimin e shërbimeve dhe investimet shtesë për të rritur shkallën e shërbimit dhe nivelin e aksesit në këto dy shërbime bazë krahasimisht me nivelet kombëtare.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Riorganizimi i shërbimit të ujësjellës kanalizimeve dhe investimeve shtesë për të rritur aksesin e banorëve në nivele të krahasueshme (jo më pak se) me normat mesatare kombëtare të publikuara nga Ministria e Punëve Publike dhe Transportit

4. Rezultatet e Pritura (dhe Indikatorët e Projektit)

- Riorganizimi i shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimeve të ujrave të zeza për të përfshirë të gjitha njësitë e amalguara në një entitet të vetëm të shërbimit që u shërben gjithë banorëve: (një entitet shërbimi i organizuar si korporatë publike, total i popullsisë për të shërbyer më tepër se 27000 banorë, përqindja e aksesit në rrjetin e ujësjellësave më tepër se 85% dhe për ujrën e zeza më tepër se 50%)
- Vendosja e tarifave unike të shërbimit për furnizimin me ujë dhe kanalet e ujrave të zeza në gjithë territorin e bashkisë së re Mat (Tarifa e publikuar dhe përfshirë në paketën fiskale të miratuar nga Bashkia Mat ose brënda taksës së gjelbërimit).
- Krijimi i një sistemi të llogaritjes së kostos së shërbimit të integruar furnizim me ujë dhe rrjet kanalizime ujra të zeza (kosto për banor dhe pasojë tarifë e njëjtë për të gjithë banorët e mbuluar me shërbimin).
- Rritja e nivelit të arkëtimit nga njësia e shërbimit (bilanci i veprimtarisë së njësive të shërbimit jonegativ).

- Investimet të reja për të përmirësuar aksesin e banorëve në këto shërbime të realizuara nga Bashkia Klos (plane dhe zbatim i projekteve të investimit nga Bashkia Mat).
- Investime për rritjen e efektivitetit të shërbimit dhe faturimit të shërbimit dhe pakësuar humbjet (investimet në aparate matëse, kalimi nga tarifimi mbi shume fikse në tarifë për m³).

5. Aktivitetet e Projektit

- Studimi për sistemin e shërbimit të integruar të ujesjellësit dhe ujrave të zeza dhe mënyrën e organizimit të entitetit të shërbimit (shoqeri aksionare apo bashkia).
- Rishikimi i planeve dhe projekteve të ish njësive për investime dhe kanalizime dhe krijimi i një plani të integruar të ketyre investimeve në kordinim me strukturën përgjegjëse në nivel qëndror (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit)
- Harmonizimi i rregullores dhe statutit të njësisë që ofron shërbimin me ligjin mbi decentralizimin dhe financat lokale.
- Aprovimi në Këshillin Bashkiak e plan projekteve të investimeve dhe kërkesave për financim nga donatorë ose FSHZH apo Fondi Rajonal i Zhvillimit.
- Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak.
- Zhvillimi i materialeve promocionale për promovimin dhe modalitetet e shërbimit(fletëpalosje)

6. Maturiteti i Projektit

Aktualisht shërbimi i furnizimit me ujë në njësitë që do të bashkohen për formimin bashkisë Burrel ofrohet nga komunat në ndryshim nga bashkia e Burrelit ku shërbimi ofrohet nga nje shoqeri aksionere. Studimi pritët ta validojë ose të rekomandojë mënyrën e shërbimit nëpërmjet shoqërive aksionare.

Ekzistojnë shume plan projekte investimesh në zonë nga ish komunat apo bashkia Klos të cilat duhet të ripunohen për t'iu përshtatur realitetit të ri të punës të funksionimit të bashkisë Mat.

Ligji i ri Organik i Decentralizimit, Financave Lokale pritët të specifikojë kompetencat dhe mënyrën e organizimit të shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve nga njësitë e qeverisjes vendore.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Transferta e Pakushtëzuara
- Të ardhurat e veta nga tarifa
- Donatorët

- Fond i Mbështetjes së Decentralizimit

Partnerët:

- Bashkia Mat
- Qeveria Qëndrore dhe Qarqet
- Donatorë: BE, Berzh, Kwf

8. Kosto e Projektit

Studimi për sistemin e shërbimit të integruar të ujesjellësit dhe ujrave të zeza dhe mënyrën e organizimit të entitetit të shërbimit	800,000
Aprovimi në Këshillin Bashkiak dhe hapja e prokurimit për investimet dhe shërbimin. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak	0
Rishikimi i planeve dhe projekteve të ish njësive për investime dhe kanalizime dhe krijimi i një plani të integruar të ketyre investimeve në kordinim me strukturën përgjegjëse në nivel qendror (Ministria e Punëve Publike dhe Transportit)	0
Harmonizimi i rregullores dhe statutit të njësisë që ofron shërbimin me ligjin mbi decentralizimin dhe financat lokale	0
Aprovimi në Këshillin Bashkiak e plan projekteve të investimeve dhe kërkesave për financim nga donatorë ose FSHZH apo Fondi Rajonal i Zhvillimit. Aprovimi i tarifës së shërbimit si pjesë e paketës fiskale të aplikuar nga Bashkia dhe përfshirja e të ardhurave/shpenzimeve në plan/zbatimin e buxhetit bashkiak.	0
Zhvillimi i materialeve promociionale (2000 copë)	100,000
Total:	900,000

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Përmirsimi i Shërbimit të Planifikimit të shërbimit public të transportit (Bashkia Mat)
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike + Quick Start</i>
Vendi i Projektit	<i>Burrel, Koms, Lis, Macukull, Baz, Ulëz, Rukaj, Derjan,</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	0 lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njësive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Shërbimi i transportit publik dhe mirembajtjes së rrugëve janë të lidhura me njësitet lokale përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe nxjerrjen e licensave për transport publik atje ku ky kryhet nga privatët. Rritja e cilësisë së shërbimit publik varet jo vetëm nga rregullimi i aktivitetit të transportit publik me anë të një sistemi efektiv licensash por edhe nga aftësia e njësive të qeverisjes lokale për të gjeneruar mjaftueshmerisht të ardhura për të përmirësuar infrastrukturën rrugore si pasojë e rritjes së aktivitetit formal të transportit publik dhe eliminimit të informalitetit. Rritja e aftësive të planifikimit të kostove/trafikut/licensave dhe investimeve në infrastrukturën rrugore në bashkinë e re të Matit janë pra të ndërlidhura dhe i shërbejnë synimit final të përmirimit të cilësisë së shërbimit të transportit publik.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Përmirsimi i aftësive të planifikimit të transportit publik dhe investimeve në infrastrukturë si parakusht për të përmirësuar cilësinë e transportit publik në Bashkinë Mat.

4. Rezultatet e Pritura (dhe Indikatorët e Projektit)

- Inventarizimi i rrugëve lokale të Bashkisë Mat dhe i kushteve të tyre teknike: (kategoritë dhe gjatësia, ashpërsia dhe kushtet teknike, volumi i trafikut dhe lloji i automjeteve, banoret që kanë akses)
- Instalimi i modelit të planifikimit rrugor në Excel sipas modelit të thjeshtuar të bankës botërore për të përcaktuar koston e transportit dhe planifikimin e investimeve (përcaktimi i parametrevë të modelit dhe perlllogaritja e kostove të tipeve të ndryshme të transportit publik sipas gjendjes së rrugës, planifikimi i investimeve dhe mirembajtjes së rrugëve si pjesë e buxheteve afatshkurtra dhe afatgjata)
- Vendosja e licensave unike dhe të kombinuara për transportin publik në Bashkinë Mat (Licensa e publikuar dhe përfshirë në paketën fiskale të miratuar nga Bashkia Mat).
- Rritja e nivelit të arkëtimit nga njësia e shërbimit dhe ulja e nivelit të informalitetit në sektor (arkëtimet nga shitja e licensave dhe volumi i automjeteve që ushtrojnë aktivitetin në mënyrë informale).

- Investimet të reja për të përmirësuar infrastrukturën lokale të Bashkisë Mat (plane dhe zbatim i projekteve të investimit nga Bashkia Mat).

5. Aktivitetet e Projektit

- Inventari i Rugëve, trafikut dhe automjeteve.
- Instalimi i Software dhe Modulit të planifikimit sipas versionit të thjeshtuar dhe falas të BB.
- Përkthimi i Modulit dhe Trainimi i Përdoruesve të Modelit
- Perlogaritja e Licensave të reja për Bashkinë Mat dhe shitja e tyre
- Planet e reja të investimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore në buxhetet afatshkurtra dhe afatmesme të Bashkisë Mat.

6. Maturiteti i Projektit

Nuk ka asnjë modul dhe program të instaluar në nivel bashkie për momentin. Nga ana tjetër modeli është falas dhe përkthimi dhe instalimi i tij mund të bëhet direkt nga punonjësit e bashkisë.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Transferta e Pakushtëzuara
- Të ardhurat e veta nga licenca e transportit

Partnerët:

- Bashkia Mat

8. Kosto e Projektit

Inventari i Rugëve, trafikut dhe automjeteve.	0
Instalimi i Software dhe Modulit të planifikimit sipas versionit të thjeshtuar dhe falas të BB.	0
Përkthimi i Modulit dhe Trainimi i Përdoruesve të Modelit	0
Perlogaritja e Licensave të reja për Bashkinë Mat dhe shitja e tyre	0
Planet e reja të investimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore në buxhetet afatshkurtra dhe afatmesme të Bashkisë Mat.	0
Total:	0

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Përmirsimi i Shërbimit të Planifikimit të shërbimit public të transportit (Bashkia Klos)
Tipi i Projektit	<i>Shërbimet Publike + Quick Start</i>
Vendi i Projektit	<i>Klos, Suç, Xibër, Gurrë</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	0 lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Në situatën e re të dale nga shkrirja dhe amalgimi i njesive lokale të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Shërbimi i transportit publik dhe mirembajtjes së rrugeve janë të lidhura me njësitë lokale përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe nxjerrjen e licensave për transport publik atje ku ky kryhet nga privatët. Rritja e cilësisë së shërbimit publik varet jo vetëm nga rregullimi i aktivitetit të transportit publik me anë të një sistemi efektiv licensash por edhe nga aftësia e njesive të qeverisjes lokale për të gjeneruar mjaftueshmerisht të ardhura për të përmirësuar infrastrukturën rrugore si pasojë e rritjes së aktivitetit formal të transportit publik dhe eliminimit të informalitetit. Rritja e aftësive të planifikimit të kostove/trafikut/licensave dhe investimeve në infrastrukturën rrugore në bashkinë e re të Klosit janë pra të ndërlidhura dhe i shërbejnë synimit final të përmirimit të cilësisë së shërbimit të transportit publik.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Përmirsimi i aftësive të planifikimit të transportit publik dhe investimeve në infrastrukturë si parakusht për të përmirësuar cilësinë e transportit publik në Bashkinë Klos.

4. Rezultatet e Pritura (dhe Indikatorët e Projektit)

- Inventarizimi i rrugeve lokale të Bashkisë Klos dhe i kushteve të tyre teknike: (kategorite dhe gjatësia, ashpërsia dhe kushtet teknike, volumi i trafikut dhe lloji i automjeteve, banoret që kanë akses)
- Instalimi i modelit të planifikimit rrugor në Excel sipas modelit të thjeshtuar të bankës botërore për të përcaktuar koston e transportit dhe planifikimin e investimeve (përcaktimi i parametrave të modelit dhe perlogaritja e kostove të tipeve të ndryshme të transportit publik sipas gjendjes së rrugës, planifikimi i investimeve dhe mirembajtjes së rrugeve si pjesë e buxheteve afatshkurtra dhe afatgjata)
- Vendosja e licensave unike dhe të kombinuara për transportin publik në Bashkinë Klos (Licensa e publikuar dhe përfshirë në paketën fiskale të miratuar nga Bashkia Klos).
- Rritja e nivelit të arkëtimit nga njësia e shërbimit dhe ulja e nivelit të informalitetit në sektor (arkëtimet nga shitja e licensave dhe volumi i automjeteve që ushtrojnë aktivitetin në mënyrë informale).

- Investimet të reja për të përmirësuar infrastrukturën lokale të Bashkisë Klos (plane dhe zbatimimi i projekteve të investimit nga Bashkia Klos).

5. Aktivitetet e Projektit

- Inventari i Rugëve, trafikut dhe automjeteve.
- Instalimi i Software dhe Modulit të planifikimit sipas versionit të thjeshtuar dhe falas të BB.
- Përkthimi i Modulit dhe Trainimi i Përdoruesve të Modelit
- Perlogaritja e Licensave të reja për Bashkinë Klos dhe shitja e tyre
- Planet e reja të investimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore në buxhetet afatshkurtra dhe afatmesme të Bashkisë Klos.

6. Klosuritë e Projektit

Nuk ka asnjë modul dhe program të instaluar në nivel bashkie për momentin. Nga ana tjetër modeli është falas dhe përkthimi dhe instalimi i tij mund të bëhet direkt nga punonjësit e bashkisë.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Transferta e Pakushtëzuara
- Të ardhurat e veta nga licenca e transportit

Partnerët:

- Bashkia Klos

8. Kosto e Projektit

Inventari i Rugëve, trafikut dhe automjeteve.	0
Instalimi i Software dhe Modulit të planifikimit sipas versionit të thjeshtuar dhe falas të BB.	0
Përkthimi i Modulit dhe Trainimi i Përdoruesve të Modelit	0
Perlogaritja e Licensave të reja për Bashkinë Klos dhe shitja e tyre	0
Planet e reja të investimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore në buxhetet afatshkurtra dhe afatmesme të Bashkisë Klos.	0
Total:	0 lekë

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Krijimi i shoqatave të prodhuesve të produkteve frutore: Rrush, Gështenja, Mollë, Dardhë, etj (Bashkia Klos dhe Mat)
Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik nëpërmjet zgjerimit të të ardhurave nga produktet vendore
Vendi i Projektit	<i>Te gjitha komunat gjatë luginës së Matit</i>
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	1,030,000,000 Lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Lugina e Matit ka kushte të favorshme për kultivimin e shumë drurëve frutorë dhe sidomos rrushit. Disa nga varietetet lokale janë të njohura në Mat dhe më tej (Tajga e Bardhë, e Kuqe, Cërruja etj). Megjithatë përfitimet nga prodhimi dhe tregëtimi i këtyre produkteve mbeten të kufizuara për shkak të aftësisë së ulët të investimeve në teknologjitë e prodhimit dhe të përpunimit si pasojë e madhësisë së kufizuar të fermave bujqësore dhe blektorale. Nxitja e formave të koperimit nëpërmjet krijimit të shoqatave të prodhuesve ose pëpunuesve me status juridik do të rriste aftësinë kredimarrëse dhe përfitimet nga ekonomitë e shkallës.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm duke shfrytëzuar avantazhet krahasuese dhe konkurruese vendore.

4. Rezultated e Pritura (dhe Indikatore të Projektit)

- Krijimi i shoqatave të prodhuesve dhe përpunuesve të drurëve frutorë me status juridik : (të pakten 5 shoqata të krijuara me anëtare me kontribute në asete ose kuotë antëtarësie, me borde dhe llogari bankare dhe aftësi për të hyrë në transaksione financiare me të tretë në dobi të anëtarëve të saj).
- Rritje e volumeve të shitjeve dhe të të ardhurave për fermerët vendas nga tregëtimi i produkteve vendase të akorduara nga këto shoqata në tregun lokal, rajonal dhe kombëtar (volumet e shitjeve dhe të të ardhurave në shkallë vendore më të larta se në tre vitet e fundit para krijimit të këtyre shoqatave).
- Investimi në pika grumbullimi të shoqatave respektive dhe në pajisje frigoriferike (çdo shoqatë në fund të periudhës trevjeçare të aktivitetit të ketë në pronësi të paktën një ngrehinë grumbullimi dhe magazinimi frigoriferik të produktit përkatës)
- Zhvillimi i markave lokale të regjistruara të produkteve vendore (secila nga shoqatat të ketë markën e vet të produktit përkatës).
- Lidhja me institutet rajonale dhe kombëtare të bujqësisë për mbështetjen me programe formimesh në teknologji dhe metodat pëpunimi moderne dhe në përputhje me kushtet klimatike të zonës (lidhje dhe memorandume të bashkpunimit të nënshkruara me institutin e bujqësisë BIO, të rrushit dhe të fidanëve, universitetin e Kamzës etj.)

5. Aktivitetet e Projektit

- Krijimi i shoqatave dhe vënia në veprim e tyre me një status juridik (bord, statut, administrate, seli dhe llogari bankare në bazë të legjislacionit shqiptar).
- Fillimi dhe zgjerimi i aktivitetit të ndërmjetësimit të kontratave të shitblerjes apo të përpunimit të produkteve bujqesore me të tretë në tregje lokale, rajonale, kombëtare apo nderkombëtare. Krijimi i portaleve on line/telefonikë të tregëtimit të këtyre produkteve.
- Zgjerimi i aseteve të shoqatave nëpërmjet kontributeve në pjesë, kuota nga anëtarët kundrejt pjesmarrjes në fitime apo nëpërmjet financimit me kredi me kushte lehtësuese të paguara me normat e fitimeve nga aktiviteti.
- Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe e sistemit të çertifikimit të këtyre markave nga shoqata përkatëse.
- Trainimi i fermerëve në metoda moderne të rritjes dhe përpunimit të produkteve bujqesore gjithmonë në respekt të ambientit dhe të traditave vendore.
- Aktivitete promovionale dhe informuese për të rritur shkallën e pjesmarrjes dhe anëtarësisë në këto shoqata

6. Maturiteti i Projektit

Nuk ka një koncept fillestar dhe fazë paraprake të këtij projekti.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Fond i Zhvillimit të Rajoneve
- Fondi Shqiptar i Zhvillimit
- Të ardhurat e veta nga kuotat e anëtarësisë ose Asetet e pjesmarrësve në shoqatë
- Donatorët
- Bankat dhe Institucionet

Partnerët:

- Bashkia Mat dhe Klos
- Ministria e Bujqësisë, Drejtoritë rajonale të bujqësisë institucionet e varësisë
- Donatorë: BE, BB, USAID, GIZ
- Banka: BERZH, ProCredit, Institutet e Mikrofinances

8. Kosto e Projektit (per 5 shoqata te tilla)

Krijimi i shoqatave dhe vënia në veprim e tyre	20,000,000
Fillimi dhe zgjerimi i aktivitetit të ndërmjetësimit të kontratave të shitblerjes apo të përpunimit të produkteve bujqesore me të tretë në tregje lokale, rajonale, kombëtare apo nderkombëtare. Krijimi i portaleve on line/telefonikë të tregëtimit të këtyre produkteve	0
Zgjerimi i aseteve të shoqatave nëpërmjet kontributeve në pjesë, kuota nga anëtarët kundrejt pjesmarrjes në fitime apo nëpërmjet financimit me kredi me kushte lehtësuese të paguara me normat e fitimeve nga aktiviteti	1,000,000,000

Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe e sistemit të çertifikimit të këtyre markave nga shoqata përkatëse	10,000,000
Trainimi i fermerëve në metoda moderne të rritjes dhe përpunimit të produkteve bujqesore gjithmonë në respekt të ambientit dhe të traditave vendore. Aktivitete promociionale dhe informuese për të rritur shkallën e pjesëmarrjes dhe anëtarësise në këto shoqata	0 (të përfshira në shpenzimet e veprimtarisë së shoqatave)
Total:	1,030,000,000 Lekë

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Krijimi i entiteteve të përpunimit të produkteve blegtorale (Bashkia Klos dhe Mat)
Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik nëpërmjet zgjerimit të të ardhurave nga produktet vendore
Vendi i Projektit	Te gjitha komunat e FA Mat Klos
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	31,800,000 Lekë

2. Situatat dhe Analiza e Problemit.

Zona e Matit dhe e Klosit dallohet për cilësinë e veçantë të produkteve blegtorale për arsye të klimës, bimësisë dhe ujërave të bollshme. Megjithatë kjo zonë aktualisht nuk ka asnjë impiant të përpunimit të këtyre produkteve gjë që bën që nënproduktet të mbeten në tregun lokal për shkak të mospërbushjes të standarteve së cilësisë për të kaluar në tregje kombëtare dhe ndërkombëtare. Investimet në këto impiante do të rishtin cilësinë e produkteve, mundësitë për eksportim dhe të ardhurat familjare në FA.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm duke shfrytëzuar avantazhet krahasuese dhe konkurruese vendore në produktet blegtorale.

4. Rezultatet e Pritura (dhe Indikatore të Projektit)

- Investimi në njësi të përpunimit të produkteve blegtorale në territorin e bashkive Mat dhe Klos me kapacitet deri në 1 ton në ditë për njësitë e përpunimit të qumështit dhe 800 kg në ditë për mishin (2 baxho dhe 1 sallameri të ndërtuara në territorin e FA)
- Rritje e volumeve të shitjeve dhe të të ardhurave për fermerët vendas nga tregëtimi i produkteve vendase nga këto shoqata në tregun lokal, rajonal dhe kombëtar (volumet e shitjeve dhe të të ardhurave në shkallë vendore më të larta se në tre vitet e fundit para ngritjes së këtyre njësive).
- Zhvillimi i markave lokale të regjistruara të produkteve vendore (secila nga shoqatat të ketë markën e vet të produktit përkatës).
- Lidhja me institutet rajonale dhe kombëtare të bujqësisë/blegtorisë për mbështetjen me programe formimesh në teknologji dhe metodat pëpunimi moderne dhe në përputhje me kushtet klimatike të zonës (lidhje dhe memorandume të bashkpunimit të nënshkruara me Ministrinë e bujqësisë dhe institutet e varësisë)

5. Aktivitetet e Projektit

- Studimi i Fizibilitetit të investimeve dhe kërkesë për kredi.
- Negocimi i kredisë me kushte lehtësuese pranë një institucioni financues (donator, bankë apo institucion mikrofinance).
- Akordimi i Kredive dhe fillimet e investimeve. Vënia në punë e njësive përkatëse dhe tregëtimi i mallrave të përpunuara.

- Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe e sistemit të çertifikimit të këtyre markave nga Institutet e Garantimit të cilësisë.

6. Maturiteti i Projektit

Nuk ka një koncept fillestar dhe fazë paraprake të këtij projekti.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit të Projektit.

Burimet e Financimit:

- Donatorët
- Bankat dhe Institucionet

Partnerët:

- Ministria e Bujqësisë, Drejtoritë rajonale të bujqësisë institucionet e varësisë
- Donatorë: BE, BB, USAID, GIZ
- Banka: BERZH, ProCredit, Institutet e Mikrofinances

8. Kosto e Projektit (per 5 shoqata te tilla)

Studimi i Fizibilitetit të investimeve dhe kërkesë për kredi	800,000
Negocimi i kredisë me kushte lehtësuese pranë një institucioni financues (donator, bankë apo institucion mikrofinance).	0
Akordimi i Kredive dhe fillimet e investimeve. Vënia në punë e njësive përkatëse dhe tregëtimi i mallrave të përpunuara	30,000,000
Krijimi i markave lokale të produktit vendor dhe e sistemit të çertifikimit të këtyre markave nga Institutet e Garantimit të cilësisë.	1,000,000
Total:	31,800,000 Lekë

1. Të Dhëna të Përgjithshme

Titulli i Projektit	Krijimi i skemave të kreditimit për operatorët turistikë familjarë (Bashkia Klos dhe Mat)
Tipi i Projektit	Zhvillim ekonomik nëpërmjet zgjerimit të të ardhurave nga aktivitetet e Shërbimeve
Vendi i Projektit	Bashkia Klos dhe Mat
Buxheti Total (Vlerësim Paraprak)	100,000,000 + pjesa për tu vlerësuar Lekë

2. Situata dhe Analiza e Problemit.

Territori i bashkisë Mat dhe Klos është i pasur me resurse turistike. Megjithatë infrastruktura turistike pranë këtyre zonave është e pazhvilluar ose joekzistente. Për pasojë turizmi familjar mund të jetë një alternative tërheqëse dhe konkurruese me ndikim të menjëhershëm në të ardhurat e ekonomive familjare. Për të arritur në këtë rezultat ka nevojë të investohet në përmësimin e ambienteve të brëndshme të shtëpive private që të shërbejnë si njësi pritëse për turistët individualë në njësitë malore. Disponueshmëria e një fondi kreditimi të hapur ndaj kreditimit të këtij lloji shërbimi do të përmironte cilësinë dhe rriste standartin e shërbimit në këtë drejtim.

3. Objektivat Specifike të Projektit

Zhvillim ekonomik i qëndrueshëm duke shfrytëzuar resurset turistike lokale dhe rritur cilësinë e shërbimit.

4. Rezultatet e Pritura (dhe Indikatorët e Projektit)

- Krijimi i një fondi dhe skeme financimi të investimeve me qëllim turizmin familjar me kredi me kushte lehtësuese (një fond prej 100,000,000 Lekë) i dokumentave dhe procedurave për aplikim nga operatorët familjarë.
- Të paktën një e treta e operatorëve turistikë të identifikuar shërbejnë ose rimbursohet çdo vit nga fondi i kreditimit (një e treta e njësive familjare të identifikuar të shërbyera).
- Rritje e turizmit familjar dhe të ardhura të shtuara vendore (numri i turistëve familjarë dhe i të ardhurave në shkallë vendore nga turizmi më i lartë se në tre vitet e fundit para krijimit të shoqatës).

5. Aktivitetet e Projektit

- Krijimi i fondit dhe skemës së financimit në bashkpunim me donatorët ose institucionet kredituese.
- Aplikimi dhe marrja e kredive apo rimbursimit për investimet në ekonomitë familiare me qëllim final turizmin familjar.
- Investimet familjare në funksion të rritjes së cilësië së shërbimit.
- Aktivitete promovionale dhe informuese mbi mundësitë e shërbimit nga shoqata e operatorëve të hotelerisë dhe restoranterisë.

6. Maturiteti i Projektit

Nuk ka një koncept fillestar dhe fazë paraprake të këtij projekti.

7. Burimet e Financimit dhe Partneret e Zbatimit te Projektit.

Burimet e Financimit:

- Ministria e Bujqësisë, e Turizmit, Ekonomisë Sipërmarrjes dhe Zhvillimit Ekonomik
- Donatorët.
- Banka, Institucione Mikrofinance

Partnerët:

- Bashkia Mat dhe Klos
- Ministria e Bujqësisë, Ministria e Turizmit, Ministria e Ekonomisë.
- Donatorë: BE, BB, USAID, GIZ
- Banka: BERZH, ProCredit, Institutet e Mikrofinances

8. Kosto e Projektit (per 5 shoqata te tilla)

Krijimi i fondit dhe skemës së financimit në bashkpunim me donatorët ose institucionet kredituese	100,000,000
Aplikimi dhe marrja e kredive apo rimbursimit për investimet në ekonomitë familiare me qëllim final turizmin familiar	0
Investimet familjare në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit	Pjesa e pjesmarrjes nga operatorët familjarë për tu vlerësuar
Aktivitete promovionale dhe informuese mbi mundësitë e shërbimit nga shoqata e operatorëve të hotelarisë dhe restorantisë	Për tu vlerësuar në funksion të menurës dhe mediumit të shpërndarjes
Total:	100,000,000 + pjesa për tu vlerësuar Lekë